



Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës

PROGRAMI ZGJEDHOR 2025



**Integrimi ekonomik dhe
reformimi i mbështetjes sociale**



**Arsimimi, edukimi dhe
barazia gjinore**



**Përmirësimi i kushteve
të banimit**



**Punësimi në sektorin
publik dhe privat**



Shëndetësia dhe mirëqenia



**Mbështetja për kulturën
dhe ruajtja e identitetit**



**Mbështetja për
infrastrukturën bazë**



Subvencionimi i fermerëve

Të Dashur qytetar të komunitetit Egjiptian,

Vizioni për një të ardhme të ndritur, të drejtë dhe gjithëpërfshirëse kërkon veprim dhe vendosmëri të palëkundur. Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës - IRDK, e udhëhequr nga parimet e barazisë dhe dinjitetit, është krenare për rolin që luajti në ndryshimin historik të vitit 2021, kur qytetarët e Kosovës e përcaktuan një rrugë të re të progresit. Në ato zgjedhje, besimi që na dhanë qytetarët, ishte për shpresë, për një qeverisje ndryshe, larg praktikave të së kaluarës që favorizonin privilegjet dhe padrejtësinë.

Me sloganin tonë “Me Besim dhe Unitet për Barazi dhe Dinjitet”, ne mbetemi të përkushtuar që mandati i ardhshëm të jetë një përmbushje e besimit të komunitetit tonë për Barazi dhe Dinjitet. Ndërsa kundërshtarët tanë politik vazhdojnë të mbeten peng i mentalitetit të qeverisjeve të kaluara, e cila dështoi të ofronte ndryshime reale, IRDK ka dëshmuar se uniteti dhe veprimi konkret sjellin rezultate. Për katër vite në opozitë, ata që e kishin mundësinë për shumë vite, nuk treguan asnjë shenjë reflektimi apo reforme. Ne besojmë se qytetarët e Kosovës nuk do të kthehen pas në këtë rrugë që tashmë e kemi nisur bashkë.

Programi ynë përfshin tetë shtylla kryesore, të fokusuara në fuqizimin e komunitetit Egjiptian dhe të gjithë qytetarëve, përmes:

1. **Integritet ekonomik dhe reformimin e mbështetjes sociale** – Lufta kundër varfërisë dhe papunësisë përmes përkrahjes së bizneseve të vogla dhe trajnimeve profesionale.
 2. **Arsimimit, edukimit dhe barazisë gjinore** – Ofrimi i mundësive arsimim cilësor dhe barazi dhe fuqizim të vajzave dhe grave të komunitetit tonë.
 3. **Përmirësimi të kushteve të banimit** – Sigurimi i strehimit të denjë dhe legalizimi i objekteve të banimit.
 4. **Punësimi në sektorin publik dhe privat** – Rritja e përfaqësimit në institucionet publike dhe promovimi i diversitetit në sektorin privat.
 5. **Shëndetësisë dhe mirëqenien** – Qasja më e mirë në shërbime shëndetësore për një jetë më të shëndetshme.
 6. **Mbështetjes për kulturën dhe ruajtjen e identitetit** – Investimi në trashëgiminë kulturore për të forcuar krenarinë e komunitetit Egjiptian.
 7. **Mbështetjes për infrastrukturën bazë** – Përmirësimi i infrastrukturës në vendbanimet tona.
 8. **Subvencionimit të fermerëve** – Nxitja e bujqësisë për një ekonomi rurale më të fortë.
- Ky program është një shprehje e vizionit tonë për një të ardhme ku besimi dhe uniteti janë themel i së ardhmes sonë të përbashkët. Bashkë, ne mund të përmbushim premtimin e barazisë dhe dinjitetit për të gjithë.

Me votën tuaj, do të vazhdojmë rrugën e progresit që kemi nisur së bashku.



1.

*Integrimi ekonomik
dhe reformimi i
mbështetjes sociale*



1. Integrimi ekonomik dhe reformimi i mbështetjes sociale

Varfëria e shprehur në një pjesë të komunitetit Egjiptian, pasqyrohet në shumë dimensione të shoqërisë, e që ndikojnë në mënyrë të thellë në strukturat sociale, ekonomike dhe kulturore. Prezenca e varfërisë të komuniteti Egjiptian i Kosovës dikton edhe nivelin e arsimit. Duke qenë në më shumë të varfër zoogëlohen mundësitë për edukim dhe kufizohen mundësitë e jetës. Fëmijët tanë të cilët rriten në kushte të varfëra, shpesh po përballen me pengesa për të arritur nivele të larta arsimore, dhe mos arritja e arsimimit të duhur bënë që varfëria të rritet për brezat që vijnë. Pjesa e komunitetit Egjiptian që jetojnë në varfëri, ata kanë mundësi të kufizuara për të gjetur punë të qëndrueshme dhe të paguar mirë, duke i lënë ata në një gjendje varfërie të përhershme. Pjesëtarët e komuniteti Egjiptian që jetojnë në kushte të varfërisë, shpesh nuk kanë mundësi për kujdes shëndetësor cilësor, që i bënë ata më të prirur ndaj sëmundjeve dhe çrregullimeve shëndetësore. Duke jetuar në varfëri, komuniteti Egjiptian shpesh përballlet me stereotipe dhe stigmatizim, e si pasojë e kësaj ndodh edhe izolimi social dhe diskriminimi.

Prandaj, varfëria nuk është vetëm një çështje individuale, ajo është një çështje shoqërore që kërkon angazhim të përbashkët dhe strategji të qëndrueshme për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe për të krijuar mundësi për ata që janë të marginalizuar.

Aktualisht, komuniteti Egjiptian në Kosovë përballlet me sfida ekonomike, përfshirë papunësinë dhe mungesën e mbështetjes për fillimin e bizneseve të vogla. Shumë familje jetojnë në varfëri ekstreme, me pak mundësi për zhvillim ekonomik. IRDK konsideron që integrimi ekonomik i komunitetit Egjiptian është thelbësor për të luftuar varfërinë dhe për të siguruar barazi ekonomike. Përmes përkrahjes së bizneseve të vogla dhe trajnimeve të përshtatshme, synojmë krijimin e një bazë të qëndrueshme për vetë-punësim dhe të ardhura të qëndrueshme.

Për më të varfëritë që stagnojnë në integrimin ekonomik, do të jetë e nevojshme mbështetja sociale. Është e nevojshme riolerësimi dhe reformimi i skemave sociale, për analizimin e përfitimeve që jepen për familjet me ndihma sociale, pensionistet, pleqtë e vetmuar, personat me atësi të kufizuara dhe të gjitha kategoritë e cenueshme. Digjitalizimi i proceseve dhe vlerësimi i kapaciteteve financiare të buxhetit të Kosovës për të siguruar shpërndarje të sakte të ndihmave sociale.



1. Integrimi ekonomik dhe reformimi i mbështetjes sociale

Investimi në shërbimet sociale dhe në politika për të përmirësuar kushtet e punës të punonjësve social është i nevojshme për të ofruar mbrojtje dhe mbështetje të qëndrueshme për fëmijët lëmshë kërkues, sigurimin e kushteve financiare dhe njerëzore për të përmirësuar jetën e fëmijëve lëmshë kërkues. Punëtorët social janë shumë të rëndësishëm në identifikimin dhe rehabilitimin e fëmijëve që kërkojnë lëmshë, në mënyrë që të ndihmojnë fëmijët dhe familjen për të bërë zgjidhje afatgjate të problemeve, si strehimi, arsimimi dhe mbështetjen psikosociale.

Për integrimin ekonomik dhe reformimin e mbështetjes sociale, IRDK angazhohet për:

- Zhvillimin e një programi kombëtar për përkrahjen e ndërmarrësisë, ku do të përfshihej aktivisht edhe komuniteti Egjiptian, dhe fokusi do të jetë ofrimi i mikrokredive pa interes dhe ofrimi i fondeve të vogla për të nisur biznese të reja*
- Nxitjen e projekteve të përbashkëta me sektorin privat për të krijuar vende të qëndrueshme pune për familjet e komunitetit Egjiptian*
- Krijimin e një fondi për subvencionimin e trajnimeve profesionale që lidhen me zanatet e kërkua në tregun e punës Strehimi*
- Sigurimi i këshillimit biznesor dhe zhvillimi i platformave online për të promovuar produktet dhe shërbimet e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme*
- Digjitalizimin e proceseve dhe vlerësimin e kapaciteteve financiare të buxhetit të Kosovës për të siguruar shpërndarje të saktë të ndihmave sociale*
- Përmirësimin e kushteve të punës të punonjësve social.*



2.

*Arsimimi, edukimi
dhe
barazia gjinore*

IRDK - 111



2. Arsimimi, edukimi dhe barazia gjinore

Arsimimi dhe edukimi i komunitetit Egjiptian në Kosovë është çështje shumë e rëndësishme për fuqizimin socio-ekonomik dhe për përmirësimin e pozitës tonë në shoqëri. Procesi i arsimimit ka ndikime të drejtpërdrejta në reduktimin e varfërisë, forcimin e të drejtave njerëzore dhe krijimin e një shoqërie më të drejtë dhe të barabartë.

Për ne Egjiptianët e Kosovës, arsimimi është një nga rrugët më të rëndësishme për të thyer ciklin e varfërisë dhe për të krijuar mundësi më të mira për brezat e rinj. Qasja në arsim cilësor mundëson zhvillimin e aftësive të nevojshme për të hyrë në tregun e punës dhe për të përmirësuar kushtet e jetesës. Edukimi gjithashtu na pajisë secilin prej neve me njohuri dhe vetëbesim për të mbrojtur të drejtat tona.

Për të qenë të barabartë në Kosovë, do të thotë edhe të jemi të arsimuar sikur komunitetet tjera, prandaj përmes arsimimit, ne Egjiptianët e Kosovës kontribuojmë në ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe harmonike.

Arsimimi i komunitetit Egjiptian është i rëndësishëm edhe për të sfiduar stereotipet dhe paragjykimet që ekzistojnë në shoqërinë tonë. Përmes edukimit, promovohet vetëdijesimi për diversitetin dhe barazinë, që ndihmon në zvogëlimin e diskriminimit dhe në rritjen e respektit të ndërsjellët.

Përfaqësimi i kryetarit të IRDK-së, Elbert Krasniqit, si ministër i parë nga komuniteti Egjiptian, ilustron rëndësinë që ka arsimimi dhe lidhshipi për të frymëzuar brezat e rinj dhe për të treguar se arritjet janë të mundshme për të gjithë, pavarësisht prejardhjes etnike. Ky shembull është një dëshmi e fuqisë së arsimimit për të ndryshuar perceptimet dhe për të krijuar mundësi të barabarta.

Një numër i madh i fëmijëve të komunitetit Egjiptian përballen me sfida në qasjen ndaj arsimit, përfshirë braktisjen e hershme të shkollimit. Kjo krijon një barrierë të madhe në mundësitë për të përparuar si komunitet.

IRDK e konsideron se arsimimi dhe edukimi është çelësi për përparim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Parandalimi i braktisjes së shkollimit dhe ofrimi i mbështetjes për studentët siguron që brezi i ardhshëm të ketë më shumë mundësi për një jetë më të mirë dhe një rol të rëndësishëm në shoqëri.

Fuqizimi i qendrave ekzistuese të edukimit jo-formal, të cilat tashmë funksionojnë me udhëzim administrativ nga MASHT, përmes rritjes së buxhetit për funksionimin e tyre. Këto qendra jo vetëm që ndihmojnë në parandalimin e braktisjes së shkollës, por gjithashtu forcojnë komunikimin midis shkollës, prindërve dhe nxënësve, si dhe përmirësojnë performancën akademike të fëmijëve.



2. Arsimimi, edukimi dhe barazia gjinore

Është e nevojshme gjithashtu krijimi i mundësisë për studentët e komunitetit Egjiptian që studiojnë edukimin parafillor dhe fillor që të kryejnë praktikën në këto qendra, duke rritur shanset për punësimin e tyre pas diplomimit.

Promovimi i edukimit parashkollor, që ka për qëllim të nxisë regjistrimin e fëmijëve në shkollën fillore dhe të lehtësojë kalimin nga parashkollorja në arsimin fillor, duhet te jete prioritet. Fokusi në veçanti duhet të vendoset te fëmijët që hyjnë në arsimin e ulët (klasat 6-9), duhet të sigurohet që regjistrimi dhe përgatitja e tyre të jetë e lehtë dhe e natyrshme edhe për shkollën e mesme.

T'ju mundësohet arsimimi për ata që kanë braktisur shkollën herët, për shkak të rrethanave të ndryshme sociale, ekonomike apo për arsye të tjera (p.sh. zhvendosje brenda ose jashtë vendit).

Zhoillimi i një kurrikule të përshtatur për këta individë dhe ofrimi i mundësive për testim paraprak janë hapa të rëndësishëm për përfshirjen e tyre në edukimin për të rritur në mënyrë që të ndihen të barabartë me të tjerët, dhe t'ju mundësohet automatikisht që të regjistrohen në trajnime profesionale që ofrohen nga QAP për të qenë pastaj të gatshëm për tregun e punës.

Është e nevojshme që të krijohen mundësi të veçanta për regjistrimin në shkolla për fëmijëve që kanë kaluar moshën për të hyrë në klasën e parë, në bashkëpunim me qendrat mësimore (QM), për t'i përgatitur ata në mënyrë të përshtatshme për edukimin që i pret.

Legjislacioni i arsimit, obligon institucionet përgjegjëse si: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, komunat, institucionet arsimore dhe komunitetin, që të marrin të gjitha hapat e arsyeshëm që institucionet arsimore të jenë cilësore, gjithëpërfshirëse, humane dhe të sigurta, siç e kërkojnë politikat arsimore, përfshirë standardet për shkollat mike, kurrikulat dhe secila hallkë e sistemit arsimor.

Duhet të ketë përpjekje për përmirësimin e standardeve për çdo hallkë të sistemit arsimor, përfshirë kurrikulat dhe kushtet e nevojshme për mësim.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është rritja e monitorimit dhe mbikëqyrjes nga Inspektorati i Arsimit, për të parandaluar braktisjen e shkollës. Arsimi është një përgjegjësi e përbashkët e prindërve dhe institucioneve arsimore, dhe nëse prindërit nuk bashkëpunojnë me këto institucione apo nuk plotësojnë kërkesat, duhet të merren masa disiplinore për të zvogëluar braktisjen.



2. Arsimimi, edukimi dhe barazia gjinore

Barazia gjinore në Kosovë ka qenë një çështje e rëndësishme, veçanërisht në kontekstin e komuniteteve të ndryshme etnike dhe kulturore që jetojnë në Kosovë. Promovimi i te drejtave të grave dhe barazia gjinore do të kontribuojnë në promovimin dhe avancimin e te drejtave te njeriut.

Për arsimimin, edukimin dhe barazinë gjinore, IRDK angazhohet për:

- Implementimin e një programi të posaçëm për të parandaluar braktisjen e shkollës fillore, duke përfshirë mentorimin dhe mbështetjen psiko-sociale për fëmijët e rrezikuar*
- Ofrimin e bursave të plota për nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët e dalluar të komunitetit Egjiptian, si dhe sigurimi i pajisjeve shkollore për të gjithë nxënësit*
- Organizimin e kampeve verore arsimore dhe aktiviteteve jashtëshkollore për të rritur përfshirjen dhe angazhimin e të rinjve në arsim*
- Fuqizimin e qendrave ekzistuese të edukimit jo-formal*
- Sigurimin e qendrave të përkrahjes për nxënësit që kanë nevojë për mësim plotësues dhe përgatitje për provime*
- Promovimin e barazisë gjinore përmes arsimimi dhe pjesëmarrjes në tregun e punës*
- Eliminimin e vështirësive të traditave patriarkale dhe normave sociale për gratë në rolin aktiv dhe vendimmarrje*
- Luftimin e dhunës me bazë gjinore*
- Rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe të përfaqësim.*



3.

*Përmirësimi i
kushteve të banimit*



3. Përmirësimi i kushteve të banimit

Kushtet e strehimit të komunitetit Egjiptian në Kosovë janë të rëndësishme, sa i përket të drejtës tonë për një jetë të dinjitetshme. Ne jemi të vetëdijshëm se strehimi adekuat ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës, mundësitë për arsimim, shëndetësi dhe punësim, duke pasur një efekt të gjerë në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme socio-ekonomike të vendit.

Konsiderojmë se një shtëpi e sigurt dhe e qëndrueshme është diçka themelore për çdo individ, dhe mungesa e saj krijon pengesa të mëdha për zhvillimin personal dhe të komunitetit. Për ne Egjiptianët në Kosovë, përmirësimi i kushteve të strehimit paraqet një mjet për t'u larguar nga cikli i varfërisë dhe për të përmirësuar mirëqenien e tonë fizike dhe emocionale.

Kushtet e varfra të strehimit shpesh janë të lidhura me problemet shëndetësore, përfshirë ekspozimin ndaj lagështirës, izolimin e dobët termik, dhe mungesën e furnizimit të qëndrueshëm me ujë dhe energji elektrike. Përmirësimi i kushteve të strehimit do të kontribuonte për një popullatë më të shëndetshme dhe më produktive.

Një pjesë e komunitetit Egjiptian që përballet me kushte të këqija të strehimit, shpesh stigmatizohen dhe përjashtohen nga pjesëmarrja e plotë në shoqëri. Përmirësimi i kushteve të strehimit për komunitetin Egjiptian do të ndihmon në reduktimin e pabarazive sociale dhe krijimin e një mjedisi më përfshirës dhe më të drejtë.

Gjatë këtij mandati të qeverisjes, problemi i strehimit është adresuar me prioritet nga MAPL e drejtuar nga ministri Elbert Krasniqi, përmes subvencionimit të ndërtimit dhe renovimit të shtëpive për familjet që jetonin në kushte të vështira të banimit. Gjatë implementimit të këtyre programeve, janë evidentuar sfida, siç është mungesa e pronës, prona të pa mjaftueshme për ndërtim të shtëpive apo prona të që nuk mund të dokumentohen në mënyrë formale. Vazhdimi i mbështetjes së politikave të subvencionimit të strehimit përmirësojnë jo vetëm cilësinë e jetës së komunitetit Egjiptian, por ndikojnë edhe në forcimin e drejtësisë sociale në Kosovë.

Kushtet e strehimit për komunitetin Egjiptian janë një reflektim i drejtësisë sociale dhe ekonomike në Kosovë. Përmirësimi i tyre nuk është vetëm një çështje infrastrukture, por një hap vendimtar drejt ndërtimit të një shoqërie më të barabartë dhe më të përparuar, ku secili qytetar ka mundësi të barabarta për të jetuar një jetë të dinjitetshme dhe të sigurt.



3. Përmirësimi i kushteve të banimit

Familjet e komunitetit Egjiptian shpesh jetojnë në kushte të vështira banimi, përfshirë mungesën e infrastrukturës bazike dhe hapësirave të sigurt për jetesë. Legalizimi i objekteve të ndërtuara në mënyrë informale është një sfidë e vazhdueshme.

Për përmirësimin e kushteve të strehimit, IRDK angazhohet për:

- **Vazhdimin e subvencionimit për ndërtimin e rreth 30 shtëpive të reja, për çdo vit, për familjet e varfra të komunitetit Egjiptian**
- **Ndërtimin e banesave për banorët e lagjeve 28 dhe 29 në Fushë Kosovë.¹**
- **Hartimi i një programi për legalizimin e objekteve të banimit dhe përmirësimin e kushteve të sigurisë së objekteve ekzistuese**

Strehimi

¹Projekti ideor është aneks i këtij dokumenti.



4.

Punësimi në sektorin publik dhe privat



4. Punësimi në sektorin publik dhe privat

Punësimi i pjesëtarëve të komunitetit Egjiptian në sektorin publik dhe privat është me rëndësi të madhe për fuqizimin ekonomik, barazinë shoqërore dhe për përmirësimin e statusit tonë të përgjithshëm në Kosovë. Ky proces, jo vetëm që përmirëson mirëqenien e individëve dhe familjeve tona, por gjithashtu ka ndikime të rëndësishme në zhvillimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Pjesëmarrja e komunitetit Egjiptian në tregun e punës kontribuon në rritjen e solidaritetit në shoqërinë tonë dhe ul tensionet e mundshme që lindin nga pabarazia. Barazia në qasje ndaj mundësive të punës çon në një shoqëri më të drejtë dhe më të balancuar, ku të gjithë qytetarët ndihen të vlerësuar dhe të përfshirë.

Kur ne pjesëtarët e komunitetit Egjiptian kemi qasje në arsim dhe trajnim, ne mund të zhvillojmë aftësi të vlefshme që na bëjnë neve kontribuues aktiv në ekonomi. Punësimi jonë në pozita të rëndësishme, si në administratë ashtu edhe në sektorë të tjerë, e rrit potencialin e fuqisë punëtore në Kosovë dhe pasuron diversitetin profesional.

Rritja e numrit të punësuarve nga radhët e komunitetit Egjiptian çon në përmirësimin e politikave gjithëpërfshirëse që trajtojnë diskriminimin dhe promovojnë barazinë në vendin e punës. Kjo është e domosdoshme për të ndërtuar një shoqëri, ku të gjithë qytetarët kanë të drejta të barabarta dhe përfitojnë nga mundësitë e njëjta.

Punësimi i pjesëtarëve të komunitetit Egjiptian ka ndikime pozitive në të gjithë vendin, duke përmirësuar stabilitetin ekonomik, ulë varfërinë dhe promovon diversitetin në vendin e punës. Një ekonomi që përfshinë të gjitha grupet etnike është më e fuqishme dhe më e qëndrueshme, ndërsa një shoqëri më e drejtë dhe gjithëpërfshirëse rritë harmoninë dhe mirëqenien për të gjithë qytetarët.

Punësimi i drejtë dhe i barabartë i pjesëtarëve të komunitetit Egjiptian është një faktor kyç për ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më gjithëpërfshirëse në Kosovë. Politikat dhe masat që promovojnë këtë qasje do të sjellin përfitime afatgjata për zhvillimin e përgjithshëm të vendit dhe krijimin e një ambienti ku të gjithë mund të kontribuojnë dhe të lulëzojnë në mënyrë të barabartë.

Ne konsiderojmë se pjesëtarët e komunitetit Egjiptian janë të nën përfaqësuar në sektorin publik dhe shpesh përballen me diskriminim të fshehtë dhe mundësi të pakta për punësim në sektorin privat.



4. Punësimi në sektorin publik dhe privat

Për punësimin në sektorin publik dhe privat, IRDK angazhohet për:

- Zbatimin i politikave afirmative për punësimin e pjesëtarëve të komunitetit Egjiptian në administratën shtetërore, policinë, ushtrinë dhe agjencitë publike*
- Ofrimi i trajnimeve specifike për përgatitjen e pjesëtarëve të komunitetit për pozita në sektorin publik*
- Bashkëpunimi me sektorin privat për të promovuar diversitetin dhe përfshirjen në vendet e punës, duke krijuar skema të stimuluar për punëdhënësit që angazhojnë punëtorë nga komuniteti Egjiptian.*

Strehimi



5.
*Shëndetësia
dhe
mirëqenia*



5. Shëndetësia dhe mirëqenia

Duke pasur parasysh se sistemi i shëndetësisë në Kosovë ka ende nevojë për përmirësime dhe investime të shumta, gjendja shëndetësore e komunitetit Egjiptian dhe komuniteteve të tjera mbetet sfiduese për shkak të barrierave sociale, ekonomike dhe kulturore. Përmirësimi i aksesit/qasjes në shërbime, eliminimi i diskriminimit dhe edukimi shëndetësor janë hapa të domosdoshëm për krijimin e një sistemi më gjithëpërfshirës që adreson nevojat specifike të komuniteteve. Komunitetet Egjiptian, Rom dhe Ashkali ende përballen me një gjendje të vështirë në qasje dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor, sidomos në zonat rurale ku banojnë. Kjo i bën edhe më të vështirë për të arritur shërbimet shëndetësore, shpesh duke u përballur edhe me diskriminim në institucionet shëndetësore. Për më tepër, mungesa e informacionit shëndetësor i dekurajon në kërkimin e ndihmës shëndetësore, duke lejuar përhapjen e sëmundjeve që mund të parandalohen.

Edhe përkundër këtyre sfidave, IRDK mendon se sistemi i shëndetësisë në disa nivele është i rregulluar, si për shembull në kujdesin parësor shëndetësor QKMF-të funksionojnë në çdo komunë, ku ofrojnë shërbime bazë për të gjithë qytetarët, duke përfshirë edhe vaksinimin. Po ashtu, ofrohen shërbime falas për disa kategori, si personat në ndihmë sociale dhe pensionistët, përfshirë edhe fëmijët.

IRDK mendon se duhet të ketë më shumë fushata ndërgjegjësuere për ndërgjegjësimin e komuniteteve, si për shembull vaksinimi, kujdesi për diabetin, shëndeti mendor, parandalimi i sëmundjeve infektive dhe informimi i grave për shëndetin riprodhues

Gjatë mandatit katërvjeçar në Qeveri IRDK, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, ka organizuar mamografi mobile dhe vizita gjinekologjike për gratë e komuniteteve Egjiptian, Rom dhe Ashkali. Shërbimet janë realizuar në të gjitha komunat, për t'u ofruar këto mundësi grave nga komunitetet, ku mbi 250 gra kanë përfituar nga këto shërbime.



5. Shëndetësia dhe mirëqenia

Për shëndetësinë publike, mirëqenien dhe një shërbim më të mirë, IRDK angazhohet për:

- Investime në infrastrukturën shëndetësore*
- Promovimin e vaksinimit të rregullt, sidomos për fëmijët*
- Programe për ndërgjegjësimin shëndetësor dhe parandalimin e sëmundjeve ngjitëse*
- Përmirësimin e aksesit, cilësisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve shëndetësore për të gjithë*
- Organizimi i klinikave të lëvizshme dhe ekipeve mjekësore që vizitojnë rregullisht zonat e banuara nga këto komunitete*
- Furnizimi falas me barna dhe vaksina për grupet vulnerabil/cenueshme*
- Trajnime për personelin mjekësor dhe respektimin e diversitetit kulturor*
- Angazhimi i liderëve për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e kujdesit shëndetësor*
- Mundësi për punësimin e mjekëve dhe infermierëve në institucionet mjekësore.*

Strchimi



6.

*Mbështetja për
kulturën dhe
ruajtja e identitetit*

IRDK - 111



6. Mbështetja për kulturën dhe ruajtja e identitetit

Identiteti ynë i veçantë është burimi kryesor i krenarisë dhe unitetit tonë dhe një faktor përcaktues për ruajtjen e vlerave dhe traditave tona.

Ruajtja dhe promovimi i traditave të komunitetit Egjiptian kontribuon në mozaikun kulturor të Kosovës. Ky diversitet është një burim i pasur për artin, muzikën dhe festivalet kulturore, duke forcuar lidhjet mes grupeve etnike dhe duke promovuar tolerancën dhe mirëkuptimin.

Mbështetja për ruajtjen e trashëgimisë tonë ndihmon në forcimin e vetëdijes tonë etnike. Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe krijimi i qendrave për ruajtjen e trashëgimisë tradicionale na ndihmon në edukimin e brezave të rinj për historinë dhe kulturën e tonë, duke i mbajtur këto vlera gjallë.

Mbështetja për artistët, këngëtarët/instrumentistët, mediat dhe krijuesit nga komuniteti Egjiptian rritë përfaqësimin kulturor dhe mundëson promovimin e kulturës tonë në skenën kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo kontribuon në një shoqëri ku diversiteti shihet si burim i inspirimit dhe zhvillim i kreativitetit.

Nxitja e respektit dhe njohjes për kulturën tonë, ndihmon në reduktimin e stereotipeve dhe diskriminimit. Një shoqëri që respekton dhe vlerëson të gjitha kulturat, është më tolerante dhe më e drejtë për të gjithë qytetarët e saj.

Integrimi i historisë dhe kulturës së komunitetit Egjiptian në tekstet shkollore dhe në mediat e Kosovës luan një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit për kontributin tonë në zhvillimin e vendit. Kjo i ndihmon qytetarët e Kosovës të njohin dhe respektojnë diversitetin si pjesë të rëndësishme të identitetit kombëtar.

Komuniteti Egjiptian përballet me mungesë të hapësirave për aktivitete kulturore dhe mosfinancim të mjaftueshëm për promovimin e trashëgimisë tonë. Krijuesit tanë letrar dhe artistik shpesh kanë qasje të kufizuara në burime financiare dhe në platforma promovuese.

Konsiderojmë se ruajtja e identitetit kulturor dhe historik të komunitetit Egjiptian është esenciale për pasurimin e trashëgimisë kombëtare dhe për përforcimin e krenarisë tonë. Kultura dhe trashëgimia formojnë lidhjen tonë me të kaluarën dhe ndihmojnë në ndërtimin e një të ardhme të fortë.



6. Mbështetja për kulturën dhe ruajtja e identitetit

Për kulturën dhe ruajtja e identitetit tonë, IRDK angazhohet për:

- Ndërtimin e Qendrës së Egjiptianëve në qytetin e Gjakovës për të organizuar aktivitete kulturore, artistike dhe edukative*
- Sigurimi i mbështetjes nga Ministria e Kulturës për krijuesit letrarë, artistët dhe këngëtarët/instrumentistët e komunitetit Egjiptian përmes granteve të dedikuara dhe projekteve të përbashkëta*
- Digjitalizimi i trashëgimisë kulturore dhe krijimi i platformave online për të rritur qasjen dhe dukshmërinë e krijimeve artistike.*

Strehimi

²Projekti ideor i Qendrës së Egjiptianëve është aneks i programit zgjedhor.



7.

*Mbështetja për
infrastrukturën bazë*



7. Mbështetja për infrastrukturën bazë

Mbështetja për infrastrukturën bazë të komunitetit Egjiptian në Kosovë ndikon në përmirësimin e kushteve të jetesës, zhvillimin e mundësive ekonomike dhe krijimin e barazisë shoqërore. Një infrastrukturë e fortë dhe gjithëpërfshirëse ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien tonë dhe ka një reflektim të thellë në zhvillimin e përgjithshëm të vendit.

Investimet në infrastrukturën bazë, përfshirë rrjetin e ujës-jellësit dhe kanalizimit, asfaltimin, kubëzimin dhe ndriçimin e rrugëve, janë thelbësore për sigurimin e një standardi të dinjitetshëm të jetesës për komunitetin Egjiptian.

Infrastruktura e përmirësuar, si shkolla dhe qendrat e trajnimit, të pajisura mirë, ndihmon në krijimin e kushteve për arsim cilësor për të rinjtë e komunitetit Egjiptian. Kjo ndikon në rritjen e mundësive të punësimit dhe zhvillimin e aftësive që kontribuojnë në pjesëmarrjen më të madhe në tregun e punës.

Investimi në infrastrukturë lehtëson zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe nxit rritjen ekonomike. Ne mund të përfitojmë nga një infrastrukturë që mbështetë tregtinë dhe shërbimet lokale, duke ndihmuar në uljen e papunësisë dhe përmirësimin e gjendjes financiare.

Një infrastrukturë që përfshin nevojat e të gjithë qytetarëve ndihmon në uljen e pabarazive shoqërore dhe përmirësimin e bashkëjetesës ndëretnike. Barazia në qasjen ndaj burimeve dhe shërbimeve forcon besimin mes qytetarëve dhe nxit ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

Përmirësimi i infrastrukturës bazë për komunitetin Egjiptian është një investim në barazinë dhe përparimin e shoqërisë kosovare. Kjo ndihmon në krijimin e mundësive të barabarta dhe një cilësie më të lartë jete për të gjithë qytetarët, duke përforcuar themelet për një të ardhme më të ndritshme dhe të qëndrueshme.

IRDK konsideron se komuniteti Egjiptian, përkundër investimeve të Qeverisë së Kosovës gjatë këtij mandati, vazhdon të përballlet me mungesë të infrastrukturës bazike në vendbanimet tona, sikurse: rrugët e pashtruara, pengesa në furnizim me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve për ujërat e zeza, që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës dhe shëndetin e familjeve.



7. Mbështetja për infrastrukturën bazë

Në mbështetje për infrastrukturën bazë, IRDK angazhohet për:

- Vazhdimin e implementimit të projekteve për përmirësimin e infrastrukturës rrugore në lagjet ku jeton komuniteti Egjiptian*
- Vazhdimin e financimit për investime në sisteme të ujit të pijshëm për të siguruar qasje të qëndrueshme dhe të sigurt për çdo familje*
- Vazhdimin e financimit për ndërtimi dhe zgjerimin e rrjeteve të kanalizimeve për trajtimin e ujërave të zeza për të përmirësuar higjienën dhe mjedisin jetësor*
- Vazhdimin e bashkëpunimit me komunat dhe institucionet ndërkombëtare për financimin dhe zbatimin e projekteve infrastrukturore.*

Strchimi



8.

Subvencionimi i fermerëve



8. Subvencionimi i fermerëve

Subvencionimi i fermerëve u mundëson atyre të kenë qasje më të mirë në teknologji bujqësore, farëra cilësore, plehra, dhe sisteme ujitjeje, duke përmirësuar produktivitetin dhe fitimet e tyre. Ky përmirësim ekonomik rrit standardin e jetesës dhe ndihmon në zvogëlimin e varfërisë.

Bujqësia mund të luaj një rol të rëndësishëm në krijimin e vendeve të punës, dhe subvencionimi i fermerëve stimulon rritjen e bizneseve të vogla dhe të mesme bujqësore. Kjo mund të ndihmojë në zvogëlimin e papunësisë brenda komunitetit Egjiptian, duke kontribuar në një ekonomi më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Përkrahja e fermerëve tanë ndihmon në shtimin e llojllojshmërisë së produkteve bujqësore në tregjet lokale dhe në nivel të Kosovës, duke përmirësuar sigurinë ushqimore dhe duke krijuar një treg më konkurrues për të gjithë fermerët.

Duke subvencionuar praktikat bujqësore të qëndrueshme, fermerët tanë mund të promovojnë teknika miqësore me mjedisin, të cilat janë në përputhje me strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm të Kosovës. Kjo forcon stabilitetin ekologjik dhe ekonomik për brezat e ardhshëm.

Subvencionimi i fermerëve tanë rritë solidaritetin shoqëror dhe tregon përkushtimin e qeverisë për barazi dhe zhvillim gjithëpërfshirës, duke forcuar themelet për një demokraci të qëndrueshme dhe të drejtë.

Një pjesë e konsiderueshme e pjesëtarëve të komunitetit Egjiptian angazhohen në bujqësi, por shpesh përballen me mungesë të mjeteve financiare, pajisjeve moderne dhe subvencioneve për të përmirësuar prodhimin dhe të ardhurat.

Mbështetja e bujqësisë është jetike për rritjen ekonomike të familjeve që varen nga prodhimi bujqësor. Subvencionet dhe investimet e qëndrueshme përmirësojnë efikasitetin dhe ndihmojnë në sigurimin e ushqimit.

Për subvencionimin e fermerëve tanë, IRDK angazhohet për:

- **Vazhdimin e ofrimit të subvencioneve për fermerët e komunitetit Egjiptian për farëra, plehra dhe pajisje bujqësore**
- **Sigurimin e grandëve për zhvillimin e serrave dhe prodhimin modern të qëndrueshëm**
- **Trajnimin e fermerëve në teknologjitë më të reja dhe praktikat e qëndrueshme bujqësore.**

Plani i Ndërtimit të Qendrës së Egjiptianëve të Kosovës në Gjakovë

Hyrje

Qendra Kulturore e propozuar do të shërbejë si një hapësirë qendrore për promovimin e kulturës, historisë dhe traditave të Komunitetit Egjiptian në Kosovë. Zgjedhja e qytetit të Gjakovës si lokacion është një pikë të rëndësishme për historinë dhe kontributin artistik të komunitetit, duke pasur parasysh trashëgiminë e figurave si Fahri Vraniqi dhe Hadi Bajrami. Kjo Qendër do të ofrojë një mjedis të sigurt dhe modern për aktivitete kulturore, artistike dhe aktivitete tjera të komunitetit.

Objektivat Kryesore

- 1. Promovimi i Kulturës dhe Trashëgimisë:** Të pasqyrohet historia dhe tradita e Komunitetit Egjiptian në Kosovë.*
 - 2. Hapësirë Multifunkionale:** Ofron një hapësirë për koncerte, shfaqje teatrale, aktivitete të organizatave joqeveritare dhe konferenca.*
 - 3. Përfshirja Komunitare:** Të forcohet bashkëpunimi dhe përfaqësimi i komunitetit në nivel lokal dhe kombëtar.*
-

Lokacioni i Propozuar

Tokë e ofruar nga Komuna e Gjakovës, e vendosur në qendrën urbane. Lokacioni duhet të jetë lehtësisht i qasshëm dhe me potencial për zhvillim urban dhe infrastrukturor.

Përgatitja e Projektit

1. Konsultime Fillestare:

- o Takime me Komunën e Gjakovës dhe Ministrinë e Kulturës.*
- o Konsultime me përfaqësues të Komunitetit Egjiptian.*
- o Vlerësimi i nevojave dhe pritshmërisë së komunitetit.*

2. Studimi i Fizibilitetit:

- o Hartimi i një raporti mbi tokën, kushtet ndërtimore dhe infrastrukture.*
- o Analiza financiare e projektit.*

3. Projektimi Arkitektonik:

- o Konkurs për arkitektë dhe zyre projektimi.*
 - o Hartimi i planit të detajuar arkitektonik, duke përfshirë:*
 - Sallë për aktivitete kulturore (kapaciteti: 300-500 persona).*
 - Hapësira për organizata joqeveritare.*
 - Sallë për konferenca dhe punëtori.*
 - Kafene dhe galeri arti.*
-

Buxheti dhe Financimi

1. Burimet Financiare:

- o Ministria e Kulturës e Qeverisë së Kosovës (fondi kryesor).*
- o Donacione nga organizata të huaja dhe vendore.*
- o Partneritet me bizneset lokale.*

2. Kosto e Parashikuar:

Strahimi

- o Studimi i fizibilitetit dhe projektimi: 50,000 EUR*
 - o Ndërtimi i objektit: 1,000,000 EUR*
 - o Pajisjet dhe mobilimi: 200,000 EUR*
 - o Totali: 1,250,000 EUR*
-

Zhvillimi i Projektit

1. Faza e Planifikimit (0-6 muaj):

- o Hartimi i projektit dhe sigurimi i fondeve.*
- o Procedurat ligjore dhe ndërtimore me Komunën e Gjakovës.*

2. Faza e Ndërtimit (6-18 muaj):

- o Ndërtimi i strukturës kryesore.*
- o Instalimi i sistemeve teknike dhe mobilimi.*

3. Faza e Testimit dhe Hyrjes në Përdorim (18-24 muaj):

- o Testimi i hapësirave dhe pajisjeve.*
- o Ceremonia e hapjes dhe fillimi i aktiviteteve.*

Menaxhimi dhe Operacionet

1. Struktura e Menaxhimit:

o Krijimi i një bordi drejtues të përfaqësuar nga Komuniteti Egjiptian dhe institucionet lokale.

o Punësimi i stafit profesional për administrim dhe organizim aktivitetesh.

2. Programi i Aktivitetit:

o Kalendari mujor për koncerte, shfaqje teatrale dhe punëtori.

o Hapësira për organizata joqeveritare dhe aktivitete të komunitetit.

3. Mirëmbajtja:

o Planifikimi i buxhetit për shpenzimet operative dhe riparimet e nevojshme.

Konkluzioni

Ndërtimi i Qendrës Kulturore në Gjakovë do të jetë një hap i rëndësishëm drejt forcimit të identitetit dhe promovimit të kulturës së Komunitetit Egjiptian në Kosovë. Ky projekt synon të krijojë një pikë takimi për artistë, aktivistë dhe qytetarë, duke kontribuar në zhvillimin kulturor dhe social të vendit.

Riorganizimi Urban për Jetesë të Dinjitetshme

Hyrje

Pothuajse në secilin qytet të Kosovës ekziston të paktën një lagje kaotike, e banuar nga komunitetet Egjiptian, Romë, Ashkalinjë, të cilat janë me hapësira të vogla banimi, të ndërtuara nga materiali i dobët i ndërtimit, në parcela shumë të vogla. Këto hapësira banimi nuk i plotësojnë kushtet për të jetuar sepse nuk janë të izoluara, nuk kanë banjo të duhur dhe dyer e dritare të dobëta. Parcelat në të cilat janë ndërtuar shtëpitë janë me hapësirë të vogël, shumica nuk janë në emër të pronarëve dhe pothuajse nuk plotësohen kushtet për ndërtim të ri me hapësirë standarde prej rreth 80 – 100 m² për familje mesatare me 5 anëtarë. Lagjet janë kaotike, me rrugë shumë të ngushta, mungon apo nuk funksionon si duhet kanalizimi i ujërave të zeza, ka probleme me furnizim me ujë të pijshëm. Në këtë lagje behët jetë e rrezikshme, sepse kushtet brenda banimit janë larg standardeve normale të banimit dhe për këtë arsye, lehtë mund të shemben. Në hapësirat e ngushta të këtyre lagjeve, në rast të ndezjes së zjarrit në ndonjë objekt banimi, intervenimi i zjarrfikësve është shumë i vështirë, e ndoshta edhe i pa mundshëm. Gjatë mandatit të ardhshëm, duhet të fillojmë me Fushë Kosovë.

1. Analiza dhe Planifikimi

• Identifikimi i zonave problematike

Janë të gjitha qytetet e Kosovës me të paktën një lagje me probleme dhe të mbipopulluara por prioritet për mandatin e ardhshëm të Qeverisë duhet dhënë lagjeve 28 dhe 29 në Fushë Kosovë.

Fushë Kosova

Lagjet e banuara nga ashkalinjtë, egjiptianët dhe romët në Fushë Kosovë kanë zhvillim të paorganizuar, me ndërtime të dendura dhe truall nën 2 ari për shumë familje. Infrastruktura është e pamjaftueshme, me rrugë të ngushta dhe të pakalueshme, mungesë të hapësirave të gjelbra dhe parkimit. Shtëpitë shpesh nuk i përmbushin standardet minimale për ndriçim, ajrosje dhe siguri. Probleme kryesore:

- o Mbipopullim dhe mungesë e intimitetit.*
 - o Infrastruktura bazike (uji, kanalizimi, energjia elektrike) është e vjetruar ose e kufizuar.*
 - o Hapësirat publike janë pothuajse të papërdorshme.*
-

Hartimi i planeve teknike

Pasi të identifikohen zonat dhe problemet specifike, hartimi i planeve teknike siguron një qasje të detajuar dhe të realizueshme.

Vlerësimi i strukturave ekzistuese:

Inxhinierët dhe urbanistët bëjnë një inspektim të ndërtesave aktuale për të vlerësuar:

- o Stabilitetin e tyre (a janë të sigurt për banim).*
 - o Ndarjen dhe funksionalitetin e hapësirave.*
 - o Kushtet për lidhjen me rrjetet ekzistuese të infrastrukturës.*
-

2. Zgjidhja e vendbanimeve alternative

Strahimi

Përcaktimi i zonave të reja për zhvillim

Tokat publike afër vendbanimeve ekzistuese (për shembull, në periferi të qyteteve) analizohen për t'u përdorur për ndërtimin e blloqeve të reja banesore. Këto zona duhet të përmbushin kriteret si:

- o Qasja e lehtë në rrugë kryesore.*
- o Largësia nga ndotësit industrialë apo burime të tjera të rrezikut.*
- o Qasja në burimet ekzistuese të ujit dhe energjisë.*

Projektimi i banesave kolektive

Ndërtesat kolektive me 3 kate përfshijnë apartamente funksionale prej 120 m², me hapësira të përbashkëta për kopsht, parking dhe ambiente rekreative. Modelet e projektimit duhet të jenë:

- o Të përshtatshme për mjedisin (izolim termik, përdorim i energjive të rinovueshme).*
- o Fleksibile për rritje të mundshme të familjeve.*

3. Riorganizimi i lagjeve ekzistuese

Riorganizimi i zonave të liruara

Pasi të bëhet zhvendosja e familjeve, hapësirat e liruara në lagjet ekzistuese mund të përdoren për:

- o Hapësira të gjelbra dhe parqe.*
 - o Objekte publike si qendra për fëmijë, sport apo komunitet.*
 - o Përdorim komercial për të gjeneruar të ardhura.*
-

4. Financimi dhe Partneritetet

Shfrytëzimi i fondeve publike

Investimi nga buxheti i komunës dhe donacione nga qeveria qendrore.

Kredi me interes të ulët

Ofrimi i kushteve të volitshme për ata që mund të paguajnë një pjesë të çmimit të apartamentit.

Stratëji

5. Implementimi

- Faza e parë: Identifikimi i zonave problematike*
 - Faza e dytë: Ndërtimi i banesave dhe zhvendosja e familjeve.*
 - Faza e tretë: Riorganizimi i lagjeve të vjetra për hapësira publike dhe komunitare.*
 - Faza e katërt: Monitorimi dhe mirëmbajtja e zonave të reja dhe të riorganizuara.*
-

6. Përfitimet

- Përmirësimi i cilësisë së jetës: Familjet përfitojnë hapësira më të mëdha dhe më të rehatshme.*
- Shfrytëzimi efikas i tokës: Reduktim i mbipopullimit dhe kaosit urban.*
- Krijimi i hapësirave të gjelbra: Promovimi i një mjedisi të shëndetshëm për banorët.*



1

Shënjoni **VETËM NJË** subjekt politik
Oznaçite **SAMO JEDAN** politički subjekat



111  **INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK**



112  **SRPSKA LISTA**



113  **Jedinstvena Goranska Partija**



114  **PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS**



115  **PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE-PLË**



116  **SRPSKA DEMOKRATIJA**



117  **Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar**



118  **Lëvizja VETËVENDOSJE!**



119  **NOVA DEMOKRATSKA STRANKA**



120  **Partija kosovskih Srba**



121  **Naša Bošnjačka Koalicija (Naša Inicijativa i Bošnjačka stranka)**



122  **Kosova Adalet Türk Partisi**



123  **PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM**



124  **LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK**



125  **PDAK-LPB**



126  **GRADJANSKA INICIJATIVA NARODNA PRAVDA**



127  **SOCIJALDEMOKRATSKA UNIJA - SDU**




128 **Fatmir Bytyqi**



129  **Koalicioni për Familje**




130  **Yenilikçi Türk Hareket Partisi**



131  **PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK**



132  **Za Slobodu Pravdu i Opstanak**



133  **Srpski narodni pokret**




134  **KOSOVA DEMOKRATİK TÜRK PARTİSİ**



135  **Koalicija Vakati**



136  **Opre Roma Kosova**



137  **AAK - ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS NISMA - Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët**



138  **FJALA**

2

Shënjoni **DERI NË DHJETË** kandidat
Oznaçite **DO DESET** kandidata

1	2	3	4	5
6	7	8	9	10
11	12	13	14	15
16	17	18	19	20
21	22	23	24	25
26	27	28	29	30
31	32	33	34	35
36	37	38	39	40
41	42	43	44	45
46	47	48	49	50
51	52	53	54	55
56	57	58	59	60
61	62	63	64	65
66	67	68	69	70
71	72	73	74	75
76	77	78	79	80
81	82	83	84	85
86	87	88	89	90
91	92	93	94	95
96	97	98	99	100
101	102	103	104	105
106	107	108	109	110

Barazi e Dinjitet